Numër: 01-980 Datë: 13.10.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2026 merr:

V E N D I M

1. NUK akreditohet *"StarPlus Academy"*, me adresë në Fshati Pasjan – Rruga e Preshevës, Gjilan 60000, Kosovë, të paraqitura për vlerësim në kuadër të procesit të akreditimit, si në vijim:

1.1. **"Zdrukthëtar" – Niveli IV**, kualifikim i bazuar në Standardin Kombëtar të Profesionit;

1.2. **"Metalpunues" – Niveli IV**, kualifikim i bazuar në Standardin Kombëtar të Profesionit.

A r s y e t i m

Gjatë procesit të vlerësimit të institucionit "StarPlus Academy" dhe programeve të propozuara të kualifikimit profesional, paneli i ekspertëve ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe ka realizuar vizitë në terren, me qëllim të verifikimit të kapaciteteve institucionale, organizative dhe profesionale për zbatimin e programeve të planifikuara.

2. Vendimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij dispozitivi mbështetet në gjetjet e panelit të ekspertëve gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në terren, sipas të cilave institucioni nuk ka dëshmuar në nivel të mjaftueshëm përmbushjen e kërkesave për infrastrukturën, hapësirat mësimore dhe praktike, pajisjet, burimet materiale dhe kapacitetet e stafit të nevojshme për realizimin efektiv të programeve të propozuara.

Nga vlerësimi i realizuar janë evidentuar mangësi në dëshmimin e kapaciteteve infrastrukturore, materiale dhe njerëzore, të cilat ndikojnë në mundësinë e realizimit të procesit mësimor dhe praktik në përputhje me kërkesat e programeve të propozuara.

1. Programi i kualifikimit "Zdrukthëtar" – Niveli IV

Institucioni ka planifikuar realizimin e programit me 15 kandidatë për grup dhe dy grupe brenda një cikli trajnimi, përkatësisht gjithsej 30 kandidatë. Megjithatë, gjatë vizitës në terren është konstatuar se hapësirat e dedikuara për zhvillimin e procesit mësimor dhe praktik nuk ishin të përgatitura dhe funksionale në nivelin e kërkuar për realizimin e programit.

Po ashtu, institucioni nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme që konfirmojnë se resurset materiale, pajisjet, infrastruktura dhe stafi i planifikuar mund të mbështesin në mënyrë efektive numrin e kandidatëve të paraparë.

Këto gjetje janë pasqyruar në raportin e panelit të ekspertëve, përfshirë gjetjet lidhur me mungesën e kabineteve dhe hapësirave funksionale, si dhe në Aneksin 1, pikat 7–18 dhe pikën 22, që lidhen me pajisjet, resurset, infrastrukturën dhe numrin e trajnerëve në raport me numrin e planifikuar të kandidatëve.

2. Programi i kualifikimit "Metalpunues" – Niveli IV

Për këtë program, institucioni ka planifikuar realizimin e trajnimit me 15 kandidatë për grup dhe dy grupe brenda një cikli trajnimi, përkatësisht gjithsej 30 kandidatë.

Megjithatë, nga vizita në terren dhe shqyrtimi i dëshmive të paraqitura, është konstatuar se institucioni nuk ka dëshmuar në nivel të mjaftueshëm se infrastruktura, pajisjet, burimet materiale dhe stafi i planifikuar janë të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për të siguruar realizimin efektiv të programit për numrin e kandidatëve të paraparë.

Gjithashtu, nuk janë paraqitur dëshmi të mjaftueshme që konfirmojnë kapacitetet e nevojshme për organizimin dhe realizimin e trajnimit sipas strukturës së propozuar të grupeve.

Gjetjet përkatëse përfshijnë mungesën e kabineteve, punëtorive dhe hapësirave funksionale për realizimin e programit, si dhe mangësitë e evidentuara në Aneksin 1, pikat 9–19, lidhur me infrastrukturën, pajisjet dhe burimet materiale, dhe pikat 20–22, lidhur me stafin dhe numrin e trajnerëve të angazhuar.

Duke u bazuar në këto gjetje, paneli i ekspertëve ka vlerësuar se kapacitetet e dëshmuara nga institucioni nuk janë të mjaftueshme për të garantuar realizimin e programeve sipas kërkesave përkatëse të cilësisë.

Rrjedhimisht, duke marrë parasysh raportin e panelit të ekspertëve dhe rekomandimet e paraqitura, Këshilli Drejtues vlerëson se nuk janë krijuar kushtet e nevojshme për miratimin e akreditimit të programeve të lartcekura.

Për këto arsye, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas praninit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

- "StarPlus Academy"
- Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve